

Drejtoria për Buxhet dhe Financa

DBF gjatë tre mujorit të parë janar-mars 2023, ka arritur me sukses të plotë të realizojë planin e punës dhe planifikimin e buxhetit komunal për këtë periudhë.

Në dy sektorët që udhëheqim ne, në sektorin e Financave dhe të Tatimit në Pronë, janë realizuar të gjitha aktivitetet e parapara për këtë tre mujor.

Në sektorin për financa, kemi krijuar një qëndrueshmëri dhe stabilitet të theksuar në krahasim me vitin e kaluar, kemi kaluar nëpër një situatë të jashtëzakonshme financiare, për shkak të qindra vendimeve të gjykatave dhe përmbaruesve, që na kanë vërshtuar çdo ditë dhe gjatë tërë vitit, disa herë edhe me masën e bllokimit të llogarive bankare që kanë ndodhë, deri sa kemi ekzekutuar pagesat për mbi 7 milion borxhe të trashëguara, ndërsa tani aktualisht kemi edhe rreth 4.1 milion të papaguara si obligime ndaj shpronësimeve që kanë ndodhur viteve të kaluara.

Kemi krijuar disiplinë të lartë në shpenzimin e parasë publike dhe respektim të plotë të procedurave dhe ligjit të financave publike.

● **AUDITORI kombëtar** gjatë muajit shkurt ka bërë auditimin e të gjitha pasqyrave financiare për vitin 2023, për Komunën e Gjilanit, jemi në pritje të raportit të vlerësimit, të cilin do ta paraqesim me kohë edhe në Kuvendin Komunal.

▼ Është përgatitur raporti financiar Janar-Shkurt 2023

E që shkurtimisht po i prezantoj statistika lidhur me realizimin e të hyrave dhe shpenzimin e buxhetit për këtë periudhë.

Buxheti i planifikuar për vitin 2023 (Buxheti përfundimtar me mjete nga Grandi, mjete vetanake të vitit 2023, mjetet e bartura, donacione dhe participim i qytetarëve

32.741.038,59€

Pagat dhe mëditjet

15.840.563,44 €

Mallrat dhe shërbimet

6.508.332,05€

Shpenzimet komunale

646.800,00€

Subvencionet

1.301.479,81€

Shpenzime Kapitale

8.443.863,29€

Burimi i financimit përfundimtar

32.741.038,59€

Grandet

27.663.463,18€

Të hyrat vetanake vitit 2023

4.952.585,99€

Participimet dhe Donacionet

124.989,42€

Sa i përket të hyrave vetanake kemi tejkaluar për 2.6% planifikimin për këtë tre mujor, ndërsa në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, kemi rritje prej 884,085.56 euro në 1,367,118.17 euro, pra kemi 483,032.61 euro më shumë të hyra për këtë tre mujor. Prej kësaj shume, rritje reale kemi prej 174,937.61 euro.

Rritja e të hyrave vetanake në krahasim me vitin e kaluar, është bërë në disa sektorë, si:

- te Tatimi në Pronë kemi 10% rritje, prej 477,753.75 euro në 526,408.10 euro
- Te lejet ndërtimore, kemi rritje për 52%, 156 në 237 mijë euro
- Te Shëndetësia, kemi rritjen e jashtëzakonshme, prej 2,900 euro në 40,700 euro
- Kemi rritje edhe te Administrata, Shërbimet Publike, Gjeodezia, Bujqësia, Arsimi.

Me këtë angazhim dhe ritëm të punës, ne presim që deri në fund të vitit të realizojmë me sukses planifikimin e të hyrave në total prej 4.952.585,99€ dhe të tejkalojmë buxhetin komunal në përgjithësi.

Sa i përket interesimit për faljen e Tatimit në Pronë, qytetarët e Gjilanit në përgjithësi kanë vazhduar dhe i kanë paguar faturat e këtij viti, andaj deri më tani nuk ka pasur rënie të inkasimit nga pagesa e faturave të Tatimit në Pronë.

Nëse votohet Projektligji i Qeverisë në Kuvendin e Kosovës, atëherë për qytetarët që i kanë paguar faturat e këtij viti, do t'i kompozohet në faturat e vitit të ardhshëm, ndërsa ata që e ende nuk e kanë bërë pagesën e faturave të këtij viti, do t'i falen për këtë vit faturat deri në shumën 100 euro.

□ SA I PËRKET **Buxheti i shpenzuar: për këtë tre mujor**

-Pagat e Adm. Komunale, Arsimit dhe Shëndetësisë

4.308.595,98€

-Mallra dhe shërbime

753.399,97€

-Shpenzime komunale

116.416,45€

-Subvencionet

140.820,03€

-Shpenzime kapitale

298.540,81€

Gjithsejtë shpenzimet

5.617.773,25€

**● BARTJA E MJETEVE TË PASHFRYTËZUARA NË VTIN E KALUAR DHE
NGA TEJKALIMI I PLANIFIKIMIT TË TË HYRAVE VETANAKE NË 2022**

Ne si Drejtori për Buxhet dhe Financa, në bashkëpunim me të gjithë, kemi bërë bartjen e buxhetit të vitit të kaluar në shumën prej 1,471,263,61 euro të vitit 2022 si dhe 94,412.75 euro të vitit 2021.

Prej kësaj shume, kemi pasur 711 mijë euro nga tejkalimi i të hyrave vetanake komunale dhe jo mjete që nuk janë shfrytëzuar nga komuna e Gjilanit.

Ky buxhet i bartur do të shpenzohet në disa projekte që do të realizohen gjatë këtij viti, si

- **në infrastrukturë 637 mijë euro,**
- **për subvencione 459 mijë euro**
- **Mallra dhe shërbime 201 mijë euro**
- **Paga dhe mëditje 140 mijë euro**

Për seancën e ardhshme kemi propozuar që të merret vendim për ndarjen e subvencioneve për këto qëllime.

Për nënat lehona, një herë nga 100 euro pas lindjes. Në total shumën prej 95 mijë euro.

Për punësimin e 20 personave me aftësi të kufizuar, subvencionimin e pagës maj-dhjetor me nga 300 euro, vlera 48 mijë euro

Për bizneset start up për të rinjtë 85 mijë euro, prej 5 deri 7,500 euro.

Për bizneset me pronare gra 50 mijë euro, në shumën prej 3 deri në 5 mijë euro

Për të rinjtë 15 mijë euro, për pagesë tre mujore të praktikës në punë, dy muaj komuna i paguan dhe një muaj Qeveria e Kosovës

Pra 293 mijë euro, për projektet e lartcekura,

Si dhe kemi ndarë buxhet shtesë edhe për subvencione në NPL “Tregu” për blerjen e mekanizmit dhe që i shërben rritjes së ofrimit të shërbimeve nga ana e Komunës së Gjilanit edhe për subvencionet në bujqësi.

▼Në këtë tre mujor, ne si DBF, kemi filluar edhe **implementimin e rekomandimit të fundit që kemi marr nga auditori**, e që ka të bëjë me funksionalizimin e sistemit të E-Pasurisë, për të gjitha asetet dhe pasurinë e Komunës së Gjilanit. Kemi angazhuar staf shtesë për këtë çështje si dhe për të realizuar planin e inspektimit të pronave që tatimohen nga Komuna e Gjilanit.

Jemi duke hartuar planin dhe kemi filluar përgatitjet për procesin e konsultimeve publike për Kornizën Afatmesme Buxhetore 2024-2026, si dhe për buxhetin komunal 2024.

Kemi formuar Grupin Punues gjithëpërfshirës për organizimin e procesit të përfshirjes qytetare në vendimmarrje për planifikimin e buxhetit 2024 dhe këtë vit në Komunën e Gjilanit për herë qytetarët e tri fshatrave, Rinia e Gjilanit dhe Gratë e Gjilanit, do të vendosin vetë, se cilat projekte duan të futen në buxhetin komunal dhe që do të realizohen në vitin tjetër.

RAPORTI FINANCIAR Janar – Mars 2023

Buxheti i planifikuar për vitin 2023 (planifikimi fillestar)	32.599.280,87€
Pagat dhe mëditjet	15.819.572,87€
Mallrat dhe shërbimet	6.502.753,00€
Shpenzimet komunale	646.800,00€
Subvencionet	1.195.000,00€
Shpenzime Kapitale	8.435.158,00€

Financimi i planifikuar	32.599.280,87€
-	
Grandet	27.646.694,88€
Të hyrat vetanake vitit 2023	4.952.585,99€

Buxheti i planifikuar për vitin 2023 (Buxheti përfundimtar me mjete nga Grandi, mjete vetanake te vitit 2023, mjetet e bartura, donacione dhe participim i qytetarëve

	32.741.038,59€
Pagat dhe mëditjet	15.840.563,44 €
Mallrat dhe shërbimet	6.508.332,05€
Shpenzimet komunale	646.800,00€
Subvencionet	1.301.479,81€
Shpenzime Kapitale	8.443.863,29€

Burimi i financimit përfundimtar	32.741.038,59€
Grandet	27.663.463,18€
Të hyrat vetanake vitit 2023	4.952.585,99€
Participimet dhe Donacionet	124.989,42€

Buxheti i shpenzuar :

-Pagat e Adm. Komunale, Arsimit dhe Shëndetësisë	4.308.595,98€
-Mallra dhe shërbime	753.399,97€
-Shpenzime komunale	116.416,45€
-Subvencionet	140.820,03€
-Shpenzime kapitale	298.540,81€
Gjithsejtë shpenzimet	5.617.773,25€



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Financave - Ministarstvo za Finansije - Ministry of Finance
Thesari / Trezor / Treasury

Aneks 5

Gjithsej

Kodi Organizativ	Emri i Organizatës Buxhetore	Mallra dhe sherbime	Shpenzime Komunale	Subvencionet dhe Transferet	Investimet kapitale	Gjithsej
651	Komuna e Gjilanit	492,879.12	17,498.41	80,315.51	4,048,641.41	4,639,334.45

14.04.2023

ZKF Mimoza Latifaj Zymberi